



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 457/3 Prot.

Tiranë, më 17. 05. 2018

V E N D I M

Nr. 124, Datë 17. 05. 2018

Mbështetur në ligjin Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa Nr. 43, datë 30.03.2018, e bërë nga E. C., kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor (në vijim DPSHTRR) dhe Drejtorisë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor Berat (në vijim DRSHTRR Berat), në të cilën pretendon diskriminim *për shkak të bindjeve politike, gjendjes ekonomike, arsimore, shoqërore dhe gjendjes shëndetësore.*

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

E. C. sqaron se, ka punuar në pozicionin e Inxhinierit në DRSHTRR Berat, nga viti 2008 deri më datë 07.01.2018. Sipas tij, gjatë detyrës së ushtruar, ka punuar me përkushtim në pozicione të ndryshme pune duke u vlerësuar me pozitivisht nga eprorët. Në muajin Shtator 2017, është vënë në dijeni të shkresës “*Njoftim mbi fillimin e bisedimeve për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për shkak të riskstrukturimit të institucionit*” dhe më datë 7 Janar 2018, punëdhënësi i ka ndërprerë marrëdhëniet e punës.

Në përfundim ankuesi, kërkon nga KMD, të marrë masa për rikthimin e tij në punë dhe shpërblimin për dëmin psikologjik dhe moral të shkaktuar.

Pas analizimit paraprak të ankesës, u konstatua se ankuesi nuk kishte vënë në dispozicion të Komisionerit informacion të mjaftueshëm për të vijuar me shqyrtimin e ankesës, lidhur me trajtimin e pabarabartë dhe diskriminues nga ana e DPSHTRR-së dhe DRSHTRR-së Berat.

Duke qënë se në formularin e ankesës ishte lënë kontakti i ankuesit, atëherë Komisioneri nëpërmjet shkresës¹ Nr. 457 prot., datë 12.04.2018, i kërkoi informacion, prova dhe fakte me anë të të cilave ankuesi argumenton shkaqet e pretenduara në ankesë.

Gjithashtu, më datë 16.04.2018, me anë të telefonit u mor kontakt me ankuesin, por nuk vuri në dispozicion të KMD-së asnjë informacion rreth ankesës së tij.

Në këto kushte, pas analizimit të ankesës nr. 43, datë 30.03.2018, Komisioneri konstatoi se:

Ligji nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, në nenin 33, pika 4/ç të tij, parashikon se: *“Ankesa nuk pranohet nëse është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”*.

Konkretisht, mungesa e shpjegimit dhe argumentimit të shkaqeve të pretenduara dhe informacionit paraprak lidhur me sqarimin e situatës diskriminuese të kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bën që nga ana formale dhe përmbajtja e ankesës të jetë e pa plotësuar.

Përsa më lart, duke analizuar në tërësi ankesën nr. 43, datë 30.03.2018, të E. C., Komisioneri gjykon se, në rastin konkret ankesa bie ndesh me kriteret ligjore të parashikuara në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, e në këto kushte në mungesë të informacionit të mjaftueshëm ajo nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të hetimit administrativ.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 3, 12, 20, 21, pika 1, neni 32, pika 1, gërma a), nenin 33, pika 4, gërma ç) të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës nr. 43, datë 30.03.2018, së E. C., pasi ankesa nuk plotëson kriteret ligjore të parashikuara në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

¹ Referuar Lajmërim-marrjes së Postës Shqiptare, ankuesi ka marrë dijëni mbi shkresën më datë 14.04.2018

2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: bindjet politike, gjendja ekonomike, arsimore, shoqërore dhe gjendja shëndetësore)

(Fusha: Punësim)